



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 05.11.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR (ICMP)”

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.11.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantoi projektligjin, Znj. Rovenë Voda, Zëvendësministre e Brendshme, Znj. Alma Mehmeti, Shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Brendshme, Znj. Silvana Dervishi, Specialiste në Ministrinë e Brendshme, Z. Ilir Bejko, Drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji, ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

Kjo marrëveshje bashkëpunimi synon avancimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri midis datave *29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991*, si dhe në rrethana të tjera për të cilat Këshilli i Ministrave mund të kërkojë ndihmën e ICMP-së.

Marrëveshja e bashkëpunimit mbështetet në nevojën për të mbrojtur të drejtat e anëtarëve të familjes të personave të zhdukur, duke siguruar hetimin efektiv të vendodhjes të të zhdukurve dhe rrethanat e zhdukjes.

Sipas parashikimeve të marrëveshjes, kjo veprimtari do të kryhet nga ICMP-ja (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur), e cila do të krijojë një zyrë shërbimi me vendndodhje në Tiranë, për të cilën do të jetë vetë përgjegjëse për mbulimin financiar të saj, sa i takon ambjenteve, paisjeve dhe orendive për përmbushjen efektive të funksioneve. Kjo zyrë do të përdorë metoda tekniko-shkencore të zbulimit dhe të identifikimit, si dhe do të sigurojë shkëmbimin e informacionit me organet kompetente në kuadër të koordinimit të bashkëpunimit, me qëllim realizimin e aktivitetit administrativ.

Krijimi i kësaj zyre nuk do të sjellë mbivendosje me organet e zbatimit të ligjit, pasi detyrat e zyrës janë të mirëpërcaktuara dhe ato janë të pavarura nga detyrat e organeve të administratës publike. Shkëmbimi i përbashkët i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve, si dhe shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar do të bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Marrëveshja parashikon që ICMP-ja do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet e garantuara për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të 18 prillit 1961.

Diskutimet në Komision :

Deputetët në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjet dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive, ndalën dhe diskutuan mbi statistikën aktuale për personat e zhdukur, si dhe mbi statusin diplomatik që parashikohet të marrë ICMP-ja.

Pas shqyrtimit të projektligjit, Komisioni e votoi dhe miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 “Për Marrëveshjet ndërkombëtare.”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI